



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 483/8 prot.,

Datë 04.03.2026

V E N D I M
Nr. 344/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-64236-10-09-2025, me objekt “Blerje pajisje laboratorike për QTTB Fushë-Krujë”, me fond limit 17,488,500 (shtatëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH ose 180,778.37 (njëqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e shtatë) euro pa TVSH, zhvilluar më datë 16.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “ISOMETRIC” SHPK me Nipt L92207009A dhe adresë:, Rruga “Dibrës”, Kompleksi Arlis Farmacia, 10 shk.2 App. 2, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a
Rruga “Rreshit Çollaku” Godina Nr. 6/337, Tiranë (në krah të Gjykatës së Lartë)

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK me Nipt L41629009A dhe adresë: Rruga "Pavaresia" Nderresa Nr. 1, Kati i Trete, Zyra 340 dhe magazine, Mëzez, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-64236-10-09-2025, me objekt “Blerje pajisje laboratorike për QTTB Fushë-Krujë”, me fond limit 17,488,500 (shtatëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH ose 180,778.37 (njëqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e shtatë) euro pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar më datë 16.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a

II.2. Në datën 16.01.2026 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 02.02.2026, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “ALBUJI” SHPK	13,050,000 lekë s’kualifikuar
2. “CARPATHIA ALBANIA” SHPK	13,133,864 lekë kualifikuar
3. “ISOMETRIC” SHPK	15,715,700 lekë kualifikuar
4. “BIONICTECH” SHPK	16,160,268 lekë s’kualifikuar
5. “KRIJON” SHPK	17,488,499 lekë kualifikuar

II.4. Në datën 06.02.2026, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraparak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2026/6331 datë 16.02.2026 dhe me nr.483 prot., datë 16.02.2026 e operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomikë “CARPATHIA ALBANIA” SHPK nga procedura e prokurimit të sipërcituar me pretendimin si më poshtë:

“....Kompania ISOMETRIC shpk pasi ka shqyrtuar me rigorozitet vlersimin e AK mbi kualifikimin e OE Carpathia Albania, gjykon se ndodhemi para faktit te mos plotesimit te specifikimeve te kerkuara nga vete AK per shumicen e listes se pajisjeve te ndodhura ne kerkesen per kete furnizim. Duke njohur ne kapilaritet specifikimet teknike dhe instalimet perkatese te kesaj tipologjie porduktesh dhe brande perkatese te cilat plotesojne specifikimet perkatese ndjekim ne teresi nje arsyetim telelogjik dhe arrijme te bindemi qe kompani Carpathia Albania eshte e pa mundur te mbuloje specifikimet teknike per artikuj qe do te klarifikohen si me poshte kjo mbeshtetur ne teorine e eliminimit. Rrjedhimisht per artikuj konkret vetem 2 ose 3 firma prodhuese mund te mbulojne specifikimet teknike sipas specifitetit te pajisjve dhe ky OE nuk eshte disitributor ose lokal partner te asnje prej atyre kompanive pasi distributoret shqiptar qe kane autorizime perkatese nga ata prodhues qe mbulojne keto specifikime kane marre pjese vete ne prokurimin ne fjale.

1.) *Ndodhur para ketij fakti te pa kontestueshem citojme qe ky OE pa experience dhe ne trajnimet dhe instalimet perkatese e ka te pa mundur te plotesoje specifikimet dhe erkesat nga AK. Per te dokumentuar citimet perkatese citojme se OE, pas verifikimit paraprak nuk permbush specifikimet teknike per pajisjet sipas tabelës se meposhtme dhe sipa markimeve me ngjyre te verdhe, respektivisht.*

2.) *Ndodhur prej nje kohe te gjate ne kete market citojme se eshte e pamundur qe ky OE te permbush keto specifikime teknike te cituara e aq me pak te jete trajnuar nga keto kompani prodhuese per trajnimin e stafit mbi perdorimin dhe konfigurimin e pajisjeve mbi parametrat e kerkuara. Gjykojme qe ky OE e ka te pamundur te dokumentoje plotesimin e specifikimeve te cilesuara me Markim te verdhe dhe per pasoje kerkojme skualifikin e ketij OE.*

Sygjerojme ballafaqim ne sEance degjimore prane KPP-se mbi plotesimin e specifikimeve te cilat jane aq esenciale per mbarvajtjen e analizave ne laboratorin perkates por nderkohe jane aq edhe esenciale per ruajtjen e proporcionalitetit ekonomik mbi plotesimi e vlerave teknike....”

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesit, adresën dhe NUIS-et; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe formularin për publikim Nr.483/1 prot., datë 16.02.2026, me kriteret për të cilat operatori ekonomik “ISOMETRIC” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.7. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, u konstatua, se në datën 23.02.2026 pranë Komisionit Prokurimit Publik është protokolluar me shkresën nr. 483/2 prot “Formulari i Paraqitjes së Argumentave nga Operatori Ekonomik i Interesuar “CARPATHIA ALBANIA SHPK”, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK për s’kualifikimin e operatorit ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK.

II.8. Me shkresën nr.3059/25, datë 24.02.2026, protokolluar me tonën nr. 483/3 prot., datë 25.02.2026, të ardhur nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik është depozituar nga autoriteti kontraktor Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave 28/2026 datë 24.02.2026 ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës së operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK.

II.9 Me shkresën nr. 3059/25, datë 24.02.2026, protokolluar me tonën nr. 483/4 prot., datë 65.02.2026,, të ardhur nëpërmjet shërbimit postar me objek “Mbi shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “SOMETRIC” SHPK, lidhur me vlerësimin në procedurën e prokurimit me nr.Ref-64236-10-09-2025, me objekt “Blerje pajisje laboratorike për QTTB Fushë-Krujë”, është depozituar Vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave 28/2026 datë 24.02.2026 ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës së operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK.

II.10 Më datë 02.03.2026 është depozituar nga autoriteti kontraktor shkresa nr. 3059/28, datë 27.02.2026, protokolluar me tonën nr. 483/5 prot., datë 02.03.2026, me objekt “Korrigjim vendimi i KSHA nr.28/2026, datë 24.02.2026”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK për s’ kualifikimin e operatorit ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK me arsyetimin se *ky operator ekonomik nuk plotëson specifikimet të kërkuara nga vetë AK për shumicën e listës së pajisjeve të ndodhura në kërkesën për këtë furnizim....*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentet e tenderit, shtojca 8/2, “*Kriteret e Veçanta të Kualifikimit*”, pika 4 e pikës 2.3, “*Kapaciteti teknik*” të dokumenteve të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon

4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mallrat objekt prokurimi katalog dhe/ose skedë teknike nga prodhuesi ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike në mënyrë që të verifikohet pajtueshmëria dhe përputhshmëria e specifikimeve teknike të mallrave të ofertuara me specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor.

III.1.2. Në shtojcën 6“ Formulari i Specifikimeve Teknike” autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

Shtojca 6.

[Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Nr	Emri i pajisjes	Specifikimet teknike
1.	Aparat Disgregimi (Për djegien e mostrave)	Kërkesa teknike për pajisjen: 1.Kapaciteti i mostrave: Pajisja duhet të jetë në gjendje të përpunojë automatikisht të paktën 8 mostra në një cikël. Funksioni i disgregimit: -Disgreguesi duhet të mundësojë shpërbërjen e mostrave në mënyrë uniforme dhe të plotë, përgatitjen e mostrave për analiza të mëtejshme. -Duhet të jetë i përshtatshëm për lloje të ndryshme mostrash si toke, ushqim, dhe material organike. 2.Sistemi i kontrollit: -Pajisja duhet të ketë panel kontrolli me ekran digjital për programim të parametrave të procesit (kohë disgregimi, intensiteti). Duhet të ofrojë mundësi ruajtjeje të programeve të përdorura më shpesh. 3.Automatizimi: -Funksionim automatik, me nisje dhe ndalim të programuar. -Të ketë system mbrojtës për ndalimin e menjëhershëm në rast emergjence ose bllokimi. 4.Sistemi mekanik: -Motor me fuqi të përshtatshme për disgregim efikas të mostrave. -Përbërës të punuar nga materiale rezistente dhe të qëndrueshme për përdorim laboratorik. 5.Siguria: -Kapak mbrojtës transparent që lejon mbi këqyrjen e procesit dhe parandalon aksesin gjatë funksionimit. -Mbrojtje kundër mbinxehjes dhe mbingarkesës. 6.Materiali përbërës: -Pjesët e kontaktit me mostrat duhet të jenë prej çeliku inox ose material rezistente ndaj korrozionit dhe kontaminimit. 7.Furnizimi me energji: -Tensioni i punës: 230 V, 50/60 Hz -Fuqia maksimale e konsumit: jo më shumë se 2000 Ë 8.Aksesorët: -Pajisja duhet të shoqërohet me kupat e disgregimit të përshtatshme për mostra, kapakët mbrojtës, dhe manualin e përdorimit në gjuhën shqipe dhe angleze. 9.Certifikimet: Pajisja duhet të jetë e certifikuar me CE dhe të plotësojë standardet e sigurisë për pajisje laboratorike.
2.	Absorber atomik	1. Teknologjia e analizës: - Flame AAS dhe furre grafiti për analize deri në nivelet ppb . - Opsion sistemi hydride për As, Se, Hg, Sb, Bi, Te. 2. Diapazoni valësh: 190–900 nm. - Llampe xenon Arc lamp për përcaktimin e shumë elementeve në të njëjtën llambë ose ELD Llamp 3. Sistemi optik: - Monokromator tipi Czerny Turner. - Sistem korigjimi të sfondit “Zeeman background correction”. 4. Ndjeshmëria standard nën 0.001 mg/l: 5. Automatizim & aksesore zgjedhës: Përpunim i të dhënave, leximi i sinjalit dhe ndërtimi i kurbës kalibruese i kompjuterizuar. Të ketë komandim automatik të gjatësisë së valës dhe rregullimin e flakës, deri në maksimizimin e sinjalit. Preferohet sistemi me rreze të dyfishtë (double-beam) me kompensim automatik devijimet e burimit të dritës dhe devijimet e gjatësi-valës të shkaktuara nga ndryshimet e temperaturës dhe devijimet në qarqet elektronike. Saktësi e lartë matjeje: Sistemi stabilizimit të presionit të rrymës për të garantuar një flakë të qëndrueshme dhe zhurmë të ulët.

		Sistem atomizimi(djegësi) të jetë rezistent ndaj korrozionit. Teknika analizuere: Atomizim me flakë, emision me flakë , atomizim me furrë grafiti lexim të absorbancës, dhe lexim të emisionit. Gjenerim hidridi sistem i sigurt dhe i besueshëm i qarkullimit të gazit. Të ketë sistem alarmi diktimi që njofton rrjedhjen e gazit. Saktësia e Gjatësisë së Valës $\leq \pm 0.5$ nm Gjerësia e Bandës Spektrale 0.2, 0.4, 0.7, 1.4, 2.4 nm Stabiliteti i Linjës Bazë ± 0.004 Abs / 30 min Kufiri i zbulimit $\text{Cu} \leq 0.008 \mu\text{g/ml}$, $\text{Hg} \leq 0.001 \mu\text{g/ml}$, $\text{Se} \leq 0.02 \mu\text{g/ml}$, $\text{Mn} \leq 0.02 \mu\text{g/ml}$, $\text{Cd} \leq 0.01 \mu\text{g/ml}$, $\text{Cr} \leq 0.003 \mu\text{g/ml}$, $\text{Pb} \leq 0.01 \mu\text{g/ml}$, $\text{As} \leq 0.01 \mu\text{g/ml}$ Furnizimi me energji 220V, 50Hz - Djegore titaniumi 10cm për flake me acetilen dhe ajër, sifon me sensor. - Llogaritje automatike e kurbës së kalibrimit - Përputhje me standardet BS EN 15488, DIN ISO etj. Limiti i dedektimit të acetilenit në ajër $\leq 0.006\text{mg/l}$
3.	Peshore teknike	1. Kapacitet dhe rezolucion: - Kapacitet deri në 2000 g; - Rezolucion 0,01 g; - Riprodhueshmëri $\sim \pm 0,01$ g; - Linearitet $\pm 0,02-0,03$ g. 2. Pjata matjeje: - Diametri Ø jo më e madhe se 130 mm; - Kalibri: E pajisur me vetkalibrim. 3. Funksionalitet: - Densitet; përputhje me printer/PC. 4. Funksione të avancuara: - Të ketë të deklaruar shmangien termike; sigurim standard stabiliteti laboratorik. 5. Aksesore dhe opsione: - Printer, tabletë, density kit, tastier alfa numerike, gurë kalibrimi 200 g, certifikatë kalibrimi nga prodhuesi.
4.	Peshore analitike	1. Kapacitet dhe rezolucion: - Kapacitet deri në 220 g; - Rezolucion 0,1mg; - Riprodhueshmëri $\sim \pm 0,1\text{mg}$; - Linearitet $\pm 0,2$ mg. 2. Pjata matjeje: - Diametri Ø jo më e madhe se 90 mm të jete i pajisur me xham mbrojtës; - Kalibrim: I pajisur me vetkalibrim. 3. Funksionalitet: -Densitet; përputhje me printer/PC. 4. Funksione të avancuara: - Të ketë të deklaruar shmangien termike; sigurim standard stabiliteti laboratorik. 5. Aksesore dhe opsione: - Printer, tabletë, tastier alfa numerike; çertifikatë kalibrimi nga prodhuesi..
5.	Furnele elektrike laborator	Furnela elektrike, specifike për djegie -Temperaturë maksimale 370-380 gradë Celsius -Të jetë më kontroll dixhital të temperaturës (me kontroll termostatik të temperaturës) -Me tregues dixhital të temperaturës (Më afishim të temperaturës në proces në kohë reale)

		-Të jetë me veshje material rezistent ndaj kimikateve (<i>Të jete rezistente ndaj kimikateve</i>) -Të punoje në rrjetin elektrik 220V 50Hz (<i>Të përshtatet me rrjetin AC 220V 50Hz</i>)
6.	Mulli per bluarjen e mostrave	1. Procesi i bluarjes: -Teknologjia e triturimit 2. Kapacitet dhe materiali - Kapaciteti 2-2.5 kg - Çelik inoks ose çelik i veshur - Distanca midis disqeve të jetë e komandushme 3. Kërkesa te tjera - Të jetë i përshtatshëm për ambiente të brendëshme, - Niveli i ulët i zhurmës $\leq$ Db - Sistemi i mbylljes hermetike - Siguri në përdorim safety sëitch - Sistem për nxjerrje pluhuri
7.	Kape djegie (Aspirimi)	1. Funksioni: - Kapa aspirimi për laborator kimik 2. Dimensionet Gjatësia mbi 1m, Gjërësia $\leq$80 3. Ventilim: - Shpejtësi ajri 0.3–0.8 m/s; zhurmë $\leq$ 70 dB; ventilator centrifugal PP - Filter gazi me karbon aktiv 4. Materialet: - Trup prej PP porcelan të bardhë ose PVC rezistent ndaj acideve dhe bazave të forta - Materiali i tavolinës (epoxy resin) 5. Ndriçimi dhe dritarja: - LED ose fluoreshent 400 lux në sipërfaqen e punës - Xham i fortifikuar vertikal ose horizontal me mekanizëm ngritës manual ose automatik - Prizat të brendëshme te paktën 2 deri në 4 me mbrojtje ndaj lagështirës 6. Pajisje standarde: Ventilator, tub aspirimi $\varnothing$ 250 mm (4,3 m).
8.	Dejonizues uji	1. Qëllimi dhe Aplikimet: - Material laboratorik për prodhim uji ultra të pastër, Tip1(ISO). Kapacitet ~5-30 L/orë 2. Cilësia e Ujit: - $\leq 0.055 \mu\text{S/cm}$ konduktivitet; $18.2 \text{ M}\Omega\cdot\text{cm}$ rezistivitet. bakteri<0.01 CFU/mL; grimca$>0.2 \mu\text{m} < 1$ cop/mL. 3. Sistemi Filtrues: Parafiltrim sediment +Karbon - UV/UF, ultra filtrim automatikisht i shpëlarë. Të jetë i pajisur me rezervuar të përshtatshëm për të pastruar ujin e distiluar. Pompë recirkuluese për parandalimin e kontaminimit. Kontrolli i cilësisë ,alarme për filtra të bllokuara ose TOC të lartë. 4. Funksione Menaxhimi: - Ekran tiltable me ndriçim të pasëm depozita ; rezerv 10-60 L me mbyllje antibakteriale. 5. ParametraTeknikë: -Temperatur operimi 2–35 °C; 6. Përfshirje Standarde: - Sistemi me reduktor presioni, kartela ultraporoz, filtrin steril 0.2 μm, kablllo elektrike.

9.	Distilator uji	1. Kapacitet prodhimi: - Uji i distiluar: 8-12 L/orë; kapacitet rezervuari distilati: 20 L. 2. Cilësia e distilatit: - Konduktivitet $\leq 2.3 \mu\text{S/cm}$ në 25 °C. 3. Funksionalitet automatik: - Mbushje automatike, sistem monitorimi kontaminimi me ndalje automatik dhe sinjal vizual; vetstakim kur ndërpritet furnizimi me ujë. 4. Materiali përbërës: - Çelik inox për evaporator, kondensator, rezervuar dhe komponentë të distilimit; 5. Standarde dhe siguri: - Konstruktion i sigurt; komponentë të standardizuara për laboratorë; 6. Përfshirje standarde: - Pajisja me rezervuar të integruar, kran dalëse, manual përdorimi, sistem matjeje elektronik për nivel uji, sistem mbrojtjeje dhe testimi automatik. - Të jetë i pajisur me filtra për pastrimin e ujit të rrjetit. 7. Furnizimi me energji elektrike: - 220 V, 50-60 Hz,
10.	Termostat për tharjen e mostrave	1. Kapacitet dhe vëllim: - Vëllimi i brendshëm: 150-180 L; ngarkesë maksimale e brendshme: deri në 50-60 kg ; - Të ketë të paktën katër raftë . 2. Temperatura dhe Saktësia: - Intervali i temperaturës: +20 ° C deri +300 ° C (minimum +5 ° C mbi temperaturën ambientale). - Precizitet termostatik: $\pm 0.5^\circ$. 3. Ventilim & ajrosje: - Me qarkullim të komandueshëm të ajrit. 4. Siguri dhe mbrojtje: - Sistem diagnostik, alarm vizual dhe akustik në rast defektesh. 5. Materiali përbërës: - Pjesa e brendëshme çeliku të pandryshkshëm; izolim termik dhe dera me mbyllje hermetike 6. Ambient operimi: - Temperatura ambientale: +10 °C deri +35 °C**; lagështia relative e ambientit $\leq 80\%$.
11.	Konduktometer	Funksionet e matjes Conductivity, salinity, TDS, temperatura. Fushat matëse dhe saktësia saktësi $\pm 0.5\%$, rezolucion të lartë Temperatura operative dhe ambienti $-5 \dots +105^\circ\text{C}$; ambient operimi $+5 \dots +55^\circ\text{C}$ Auto Read dhe kalibrim AutoRead, 1-point, kompensim temperature. Aksesore elektrodë, bateri standart Mbrojtje IP 43
12	Tundese lineare	1. Temperatura e ambientit: - Diapazon operimi: +10 °C deri +35 °C. 2. Lloji i dridhjes: - Dridhje horizontale me amplitudë të rregullueshme, te pakten tre opsione

		3. Shpejtësia e dridhjes: - Interval shpejtësie, i ngadaltë mesatare dhe i shpejtë. 4. Kapaciteti i ngarkesës: - Ngarkesë maksimale e platformës: rreth 5-6 kg. 5. Kontroll dhe ndërfaqe përdoruesi: - Panel për kontrollin e amplitudës dhe monitorimin e shpejtësisë së tundjes; funksione alarmi dhe mbrojtjeje. 6. Ndërtimi dhe materiali: - Strukturë e fortë dhe materiale rezistente ndaj korrozionit; pjesë kontakti me mostrat prej materiali jo reaksionar. 7. Tensioni dhe furnizimi elektrik: - 220 V, 50/60 Hz. 8. Siguri dhe standarde: - Pajisje e certifikuar CE, me mbrojtje nga mbingarkesa; pajisje e përshtatshme për laboratorë. 9. Përfshirje standarde: - Pajisja përfshin platformën tundës, , kabllot e nevojshme, manualin e përdorimit dhe certifikatat e garancisë. Tavolinë për mbajtjen e pajisjes - Tavoline e përshtatshme për mbajtjen e pajisjes, të amortizojë plotësisht lëkundjet e pajisjes.
13	Pajisje distilimi (Model automatik ose gjysem automatik)	Rangu i matjes 0.1 – 240 mg N Sasia e mostrës Solide <6 g; Lëngje <16 ml Koha e matjes 4–6 minuta (me ujëftohës 18°C) Kërkesa për ujë ftohës <20°C Koncentrimi i solucionit. titrimi 0.01 – 5 mol/L Sistemi i titrimin, titrim me piston me saktësi të lartë Ripërsëritshmëria ±0.5% Koeficienti i rikuperimit ≥99.5% Memorimi i të dhënave 100,000 grupe Furnizimi me energji AC 220V, 50/60 Hz Afishon kurbën e titrimin në kohë reale Të ketë opsion vetpastrimi Shkarkim automatik i mbetjeve në tuba tretës Ekran i madh LCD me prekje Sistemi i kontrollit me saktësi të lartë dhe stabilitet të mirë Burim drite me trengjyra (R, G, B) dhe sensor trefish për përshtatshmëri të gjerë ndaj ngjyrave dhe saktësi të lartë Material prej çeliku inox 304 Funksione të shumta mbrojtjeje: derë sigurie, mbrojtje ndaj mbingarkesës me presion, mungesë uji etj.
14	Spektrofotometër	Gama e gjatësisë së valës 190 deri në 1100 nm Gjerësia e bandës spektrale 1.0 nm Sistemi optik me rreze të dyfishtë (Double beam) Saktësia e gjatësisë së valës ±0.3 nm Ripërsëritshmëria e gjatësisë së Valës ≤0.1 nm Rezolucioni i gjatësisë së valës 0.1 nm Të jetë i pajisur me skanues për zgjedhjen e gjatësisë së valës optimal me sinjalin maksimal Gama e shfaqjes fotometrike -4 deri në 4 A Modaliteti fotometrik T, A, C, E Saktësia fotometrike ±0.3% T (0 deri në 100%T) ± 0.002 A (0 deri në 0.5 A) ± 0.003 A (0.5 deri në 1 A) Ripërsëritshmëria Fotometrike 0.15% T (0 deri në 100% T) ± 0.001 A (0 deri në 0.5 A) ± 0.0015 A (0.5 deri në 1 A) Burimi i dritës llambë tungsteni, llambë deuteriumi Stabiliteti 0.0005 A/orë @500 nm

		Zhurma $\pm 0.002 \text{ A @} 500 \text{ nm}$ Sheshtësia e bazës (Baseline Flatness) $\pm 0.001 \text{ A}$ Detektori Fotodiodë silikoni Furnizimi me Energji AC 220 V, 50-60 Hz
15.	Analizator azoti protein dhe C-organik	Metoda e analizës: - Dumas (kombustion) për azotin, proteinën dhe C-organik - Dhoma e djegies jo më pak se 900°C. 1. Sensori dhe performanca: - TCD pa gaz reference; kufiri detektimit 0.003 mg N; - Rikuperim $> 99.5\%$, C-organik 0.003mg. 2. Kapaciteti i mostrës dhe autosampler: - Peshë mostra $\leq 1 \text{ g}$; 3. Gaze dhe kushte operimi: - He (99.999%, 2 bar), O (99.999%, 2 bar); ajër/azot $\geq 99.6 \%$. 4. Kontroll i kompjuterizuar i procesit dhe i dedektimit - Platforma me monitorim në kohë reale. 5. Përputhshmëria dhe standardet: - EN ISO 16634-1:2008, SSH ISO 10694:2001, SSH ISO13878:2001 - Përfshirje standarde & aksesore: - Të shoqërohet me sandartet kalibruese
16	Aparat filtrimi me vakum	Funksioni, filtrim me vakum për laboratorin -Të ketë një set me të paktën tre pozicione për filtrim -Hinka qelqi ose porcelani - Diametri $\phi 125 \text{ mm}$ -Bazamenti i hinkës qelq poroz ose qeramike. -Ena për mbledhjen e filtratit, jo më pak se 500 ml. -Pompa e vakumit, rezistente ndaj korrozionit dhe agjenteve kimike
17.	pH meter	1. Kapacitet & diapazon matjeje - pH: $0 \dots 14$ njësi pH - Rezolucion 0.001 njësi pH, me saktësi $\pm 0.005 \text{ pH}$; rezolucione të tjera: $\pm 0.01 \text{ pH}$ dhe $\pm 0.1 \text{ pH}$. 2. Temperaturë & saktësi - Matja: $6 \dots +100.0^{\circ}\text{C}$, rezolucion 0.1°C; saktësi $\pm 0.1^{\circ}\text{C}$. - Kompensim automatik temperaturor (ATC). 3. Kalibrim -1,- 2 ose-3 pikëshe me përdorim të buferëve 7pH, 4pH, 10pH - Timer për kujtesë kalibrimi automatik. 4. Funksionalitete operimi - Ekran LCD i madh, funksion AutoRead për stabilitet dhe riprodhim të automatik, tastierë intuitive për navigim të thjeshtë. 5. Elektroda - Paisur me elektrod të kombinuar, me sensor për temperaturë për matjen e temperaturës në kohe reale - Të bëjë vetë kompensimin e vlerës së matur në temperaturën 20°, ose 25°C 6. Përshtatja me rrjetin - 240 V, AC, $50/60 \text{ Hz}$; - Të ketë opsion për funksionimin me bateri standarte. 7. Aksesorët shoqërues -Tretsi bufer ike (pH 4, 7, 10.), - Elektrolit KCl 3 mol/L për mbushjen e elektrodës, - Mbajtëse për elektroda standart , - Përshtatës të rrymës AC/DC

18	Pajisje distilimi (Kjeldahl manual)	1.Kapacitet dhe dizajn fizik Kapaciteti deri në 6 mostra simultane (6-element seriali KI) për balona Kjeldahl nga 250 ml, 500–750 ml për çdo vend 2. Funksionimi dhe Temperaturë Ngrohje individuale: çdo element ngrohës ka komandim të veçantë dhe kontroll të temperaturës, për mostra me pika vlimi të ndryshme, me ngrohës performues të shpejtë Ngrohës: element tubular inox me reflektor çelik për efikasitet termik maksimal 3.Përmbajtja Duhet përfshirë në ofertë: Njësia ngrohëse serike KI (6 elemente ngrohës) Aparat komplet distilimi me Reitmair top(e), kondensatorë, dalje dhe gomë lidhëse Ballona Kjeldahl me volumen e specifikuar (p.sh. 250 ml, 500 ml, 750 ml) Erlenmeyer për mbledhje distilatit Manuali për vënien në punë dhe udhëzues instalimi 4. Kërkesat dhe Instalimi Furnitori duhet të marrë përsipër edhe instalimin e pajisjes Aksesore dhe përshtatje në mjediset ku do të instalohet Sisteme thithjeje tymi: mundësia për integrim me pompë uji ose sistem për heqje tymrash korrozivë gjatë procesit Kjeldahl 5.Siguria - Lartësi operimi e përshtatshme, strukture e qëndrueshme për reduktim të dështimeve -Materiale rezistente ndaj temperaturave të larta dhe kimikateve; performancë e qëndrueshme për përdorim intensiv
19.	Kontenjier 400-500 lit për mbajtjen e materialit biologjik me azot të lëngshëm	1.Kapaciteti dhe volumi -Volumi i brendshëm: 180-200 L -Kapaciteti: 6000 vials 1.2-2 ml, të sistemuara me kuti Cryogenic Box 2.Temperaturë dhe stabilitet - Temperatura operative: nën -180°C (temperatura e azotit të lëngët $\sim -196^{\circ}\text{C}$), ruajtje e vazhdueshme edhe kur niveli i lëngut është nën 5 cm 3.Evaporimi dhe kapaciteti statik -Norma e avullimit statik: 0.99 L/ditë -Kapacitet ruajtës statik: 185 ditë, 4.Dimensionet dhe peshat Diametri i jashtëm: 66 cm diametri brenda qafës jo më i vogël se 50 cm 5.Tipologjia dhe materialet -Lloji: Manual Fill LN Deëar; izolimi: vakum për efikasitet maksimal -Materiale kryesore: çelik inox dhe alumini, përshtatur për përdorim kriogjenik 6. Monitorimi dhe siguri i nivelit Opsional: Monitor ultrasonik i nivelit të azotit me alarm vizual dhe audio kur niveli bie nën ~ 2.5 cm, 7. Përputhshmëria Aksesoret dhe pajisjet ndihmëse Raka standarde: përkutia 2 inç (5 cm) Cryogenic, duke ruajtur kutitë me 1.0-2.0 ml vials; mundësi për aksesore për ampula 5 ml Pajisje të disponueshme: aksesore transporti, kapakë sigurie, CryoClasë, logbook etj.

Në shtojcën nr.1 , datë 19.12.2025 “Mbi modifikimin dhe ndryshimin e dokumentave standarte të tenderit”, publikuar në sistemin e prokurimit publik, autoriteti kontraktor ka modifikuar specifikimet teknike të disa prej artikujve objekt prokurimi si më poshtë:

1. ISHTE:

1.	Aparat Disgregimi (Për djegien e mostrave)	2.Sistemi i kontrollit: -Pajisja duhet të ketë panel kontrolli me ekran digjital për programim të parametrave të procesit (kohë disgregimi, intensiteti). Duhet të ofrojë mundësi ruajtjeje të programeve të përdorura më shpesh.
----	---	---

BËHET:

1.	Aparat Disgregimi (Për djegien e mostrave)	2.Sistemi i kontrollit: -Pajisja duhet të ketë panel kontrolli me ekran digjital për programim të parametrave të procesit (kohë disgregimi, temperaturë e programueshme). Duhet të ofrojë mundësi ruajtjeje të programeve të përdorura më shpesh.
----	---	---

2. ISHTE:

1.	Aparat Disgregimi (Për djegien e mostrave)	6.Materiali përbërës: -Pjesët e kontaktit me mostrat duhet të jenë prej çeliku inox ose material rezistente ndaj korrozionit dhe kontaminimit.
----	---	---

BËHET:

1.	Aparat Disgregimi (Për djegien e mostrave)	6.Materiali përbërës: -Pjesët e kontaktit me mostrat duhet të jenë prej çeliku inox ose material rezistente ndaj korrozionit.
----	---	--

3. ISHTE:

2.	Absorber atomik	5. Automatizim & aksesore zgjedhës: Gjerësia e Bandës Spektrale 0.2, 0.4, 0.7, 1.4, 2.4 nm
----	------------------------	---

BËHET:

2.	Absorber atomik	5. Automatizim & aksesore zgjedhës: Gjerësia e Bandës Spektrale 0.1 nm-2.4nm.
----	------------------------	--

		Të ketë të paktën 4 gjerësi të bandave spektrale.
--	--	---

4. **ISHTE:**

2.	Absorber atomik	5. Automatizim & aksesore zgjedhës: Preferohet sistemi me rreze të dyfishtë (double-beam) me kompensim automatik devijimet e burimit të dritës dhe devijimet e gjatësi-valës të shkaktuara nga ndryshimet e temperaturës dhe devijimet në qarqet elektronike.
----	------------------------	--

BËHET:

2.	Absorber atomik	5. Automatizim & aksesore zgjedhës: Sistem me rreze të dyfishtë (double-beam).
----	------------------------	---

5. **ISHTE:**

2.	Absorber atomik	5. Automatizim & aksesore zgjedhës: Stabiliteti i Linjës Bazë ± 0.004 Abs / 30 min.
----	------------------------	--

BËHET:

Hiqet specifikimi: (Stabiliteti i Linjës Bazë ± 0.004 Abs / 30 min).

6. **ISHTE:**

3.	Peshore teknike	2. Pjata matjeje: - Diametri Ø jo më e madhe se 130 mm;
----	------------------------	--

BËHET:

3.	Peshore teknike	2. Pjata matjeje: - Diametri Ø jo më e madhe se 80-130 mm;
----	------------------------	---

7. **ISHTE:**

10.	Termostat per tharjen e mostrave	1. Kapacitet dhe vëllim: - Vëllimi i brendshëm: 150-180 L; ngarkesë maksimale e brendshme: deri në 50-60 kg ;
-----	---	--

BËHET:

10.	Termostat per tharjen e mostrave	1. Kapacitet dhe vëllim: - Vëllimi i brendshëm: 150-180 L; ngarkesë maksimale e brendshme: jo më pak se 50 kg;
-----	---	---

8. ISHTE:

16	Aparat filtrimi me vakum	- Diametri ϕ 125 mm
----	---------------------------------	--------------------------

BËHET:

16	Aparat filtrimi me vakum	- Diametri i hinkës së qelqit ose porcelanit ϕ 125 mm - Ena mbledhëse e filtratit të ketë përshtatës për kroxhola filtër me porozitet 5 μ m deri 20 μ m.
----	---------------------------------	--

9. ISHTE:

18	Pajisje distilimi (Kjeldahl manual)	1.Kapacitet dhe dizajn fizik Kapaciteti deri në 6 mostra simultane (6-element seriali KI) për balona Kjeldahl nga 250 ml, 500–750 ml për çdo vend
----	--	--

BËHET:

18	Pajisje distilimi (Kjeldahl manual)	1.Kapacitet dhe dizajn fizik Kapaciteti deri në 6 mostra simultane (6-element seriali KI) për balona Kjeldahl 500 ml për çdo vend .
----	--	--

➤ Në shtojcën nr. 6 “Formulari i specifikimeve teknike”, bëhen **SQARIMET** si më poshtë:

I. Përsa i përket artikullit nr. 1 “Aparat Disgregimi” të Shtojcës 6 “Formulari i Specifikimeve teknike”, konkretisht heqjen e specifikimit lidhur me fuqinë e mjaftueshme të motorit, ku përcaktohej se:

1.	Aparat Disgregimi (Për djegien e mostrave)	4.Sistemi mekanik: -Motor me fuqi të përshtatshme për disgregim efikas të mostrave. -Përbërës të punuar nga materiale rezistente dhe të qëndrueshme për përdorim laboratorik.
----	---	---

Autoriteti Kontraktor përfitues ka kryer formulim më të detajuar të këtij specifikimi por duke e ruajtur si pjesë përbërëse e specifikimeve të këtij artikulli dhe konkretisht si më poshtë:

-Motor me fuqi të përshtatshme për të kryer funksionin e uljes dhe ngritjes automatike të raftit të tubave brenda dhe jashtë bllokut ngrohës. Në këtë mënyrë nuk është e nevojshme që të preken manualisht tubat e nxehtë me acid sulfurik, duke shmangur rreziqet e djegies ose spërkatjes me acid.

1.	Aparat Disgregimi (Për djegien e mostrave)	4.Sistemi mekanik: -Motor me fuqi të përshtatshme për të kryer funksionin e uljes dhe ngritjes automatike të raftit të tubave brenda dhe jashtë bllokut ngrohës. -Përbërës të punuar nga materiale rezistente dhe të qëndrueshme për përdorim laboratorik.
----	---	--

II. Përsa i përket artikullit nr. 1 “Aparat Disgregimi” të Shtojcës 6 “Formulari i Specifikimeve teknike” me kërkesën për heqjen e termit mbingarkesë, ku përcaktohej se:

1.	Aparat Disgregimi (Për djegien e mostrave)	5.Siguria: -Mbrojtje kundër mbinxehjes dhe mbingarkesës.
----	---	---

Lidhur me këtë pretendim, Autoriteti Kontraktor përfitues ka argumentuar si më poshtë:
Fjala mbingarkesë i referohet rrymës elektrike dhe motorit. Kjo parandalon dëmtimin nëse pajisja përballet me rrymë elektrike më të lartë se norma ose nëse motori ka ngarkesë të tepruar (psh. Rafti bllokohet gjatë ngritjes së mostrave). Pra, në rast të një mbingarkese elektrike të ketë mundësinë të ndërpresë automatikisht furnizimin me energji dhe të sinjalizojë operatorin nëpërmjet alarmit.

III. Përsa i përket artikullit nr. 2 “Absorber atomik” të Shtojcës 6 “Formulari i Specifikimeve teknike” duke kërkuar modifikimin e specifikimit për llampën, ku përcaktohej se:

2.	Absorber atomik	2. Diapazoni valësh: 190–900 nm. - Llampe xenon Arc lamp për përcaktimin e shumë elementeve në të njëjtën llambë ose ELD Lamp
----	------------------------	--

Lidhur me këtë pretendim, Autoriteti Kontraktor përfitues ka argumentuar si më poshtë:
Kërkesa për Absorber që operon edhe me llampa EDL lidhet me përparësitë që këto llampa ofrojnë sikurse janë:

- Intesiteti i lartë mbi 200 herë
- Nivel detektimi shumë i ulët
- Kohë stabilizimi e ulët.

IV. Përsa i përket artikullit nr. 2 “Absorber atomik” të Shtojcës 6 “Formulari i Specifikimeve teknike” lidhur me heqjen e Standardeve BS EN 15488, DIN ISO etj duke e konsideruar lapsus të AK, ku përcaktohej se:

2.	Absorber atomik	5. Automatizim & aksesore zgjedhës: -Përputhje me standardet BS EN 15488, DIN ISO etj.
----	------------------------	---

Lidhur me këtë pretendim, Autoriteti Kontraktor përfitues ka argumentuar si më poshtë:
Përkundër pretendimit të ankimesit, këto standarde janë përdorur si referencë për parametrat që duhet të plotësojë pajisja për analizat e përmbajtjes së bakrit (Cu).

V. Përsa i përket artikullit nr. 3 “Peshore teknike” të Shtojcës 6 “Formulari i Specifikimeve teknike” duke kërkuar heqjen e termit sigurim standard stabiliteti laboratorik, ku përcaktohej se:

3.	Peshore teknike	4. Funksione të avancuara: - Të ketë të deklaruar shmangien termike; sigurim standard stabiliteti laboratorik.
----	------------------------	---

Lidhur me këtë pretendim, Autoriteti Kontraktor përfitues ka argumentuar si më poshtë:
Termi “Sigurim standard stabiliteti laboratorik” nënkupton stabilitetin e leximit $\leq \pm$ njësi leximi minimal si dhe stabilitet afatgjatë $\leq \pm 0.01\%$ e peshës së matur për një vit.

VI. Përsa i përket artikullit nr. 6 “Peshore analitike” të Shtojcës 6 “Formulari i Specifikimeve teknike” duke kërkuar heqjen e specifikimit sistem i mbylljes hermetike, ku përcaktohej se:

6.	Mulli për bluarjen e mostrave	Kërkesa të tjera - Sistemi i mbylljes hermetike
----	--------------------------------------	--

Lidhur me këtë pretendim, Autoriteti Kontraktor përfitues ka argumentuar si më poshtë:
Mulliri për bluarjen e mostrave (sidomos të produkteve plehëruese) duhet të jetë i mbyllur hermetikisht për arsye sigurie. Nëse mulliri nuk është i mbyllur mund të ndodhë:

- Shpërndarje pluhuri në ajër (rrezik për frymëmarrjen).
- Kontaminim i ambientit.
- Humbje e mostrës gjatë bluarjes.

VII. Përsa i përket artikullit nr. 9 “Distilator uji” të Shtojcës 6 “Formulari i Specifikimeve teknike” duke kërkuar heqjen e specifikimit konstruksion i sigurt; komponentë të standardizuara për laboratorë, ku përcaktohej se:

9.	Distilator uji	5. Standarde dhe siguri: - Konstruksion i sigurt; komponentë të standardizuara për laboratorë;
----	-----------------------	---

Lidhur me këtë pretendim, Autoriteti Kontraktor përfitues ka argumentuar si më poshtë:

- Konstruksion i sigurtë do të thotë që pajisja është projektuar për të parandaluar rreziqe gjatë përdorimit (rrjedhje uji, avuj apo rryme elektrike). Kjo përfshin mbrojtje elektrike, mbrojtje termike dhe mekanike.
- Komponentë të standardizuar për labore do të thotë që të gjitha pjesët e distilatorit janë të prodhuara sipas standardeve ndërkombëtare laboratorike (ISO, DIN, CE).

VIII. Përsa i përket artikullit nr. 15 “Analizator azoti protein dhe C-organik” të Shtojcës 6 “Formulari i Specifikimeve teknike” duke kërkuar heqjen e specifikimit të raportit ajër/azot=99.6% pasi krijon paqartësi, ku përcaktohej se:

15.	Analizator azoti protein dhe C-organik	3. Gaze dhe kushte operimi: ajër/azot $\geq 99.6\%$.
-----	---	--

*Lidhur me këtë pretendim, Autoriteti Kontraktor përfitues ka argumentuar si më poshtë:
Raporti Ajër/Azot=99.6% do të thotë pastërtia minimale e gazit që përdoret si gaz mbajtës ose oksidues në analizator. Siguron saktësi dhe stabilitet të matjeve. Roli në analizator është që transporton dhe ndihmon djegien e mostrës, parandalon ndërhyrjet në detektor. Si i tillë, nuk është teknikisht i pasaktë.*

III.1.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK, për plotësimin e kriterit të mësipërm, rezulton, se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon:

- Shtojca 9 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit” ku operatori ekonomik ka plotësuar Pjesën III “Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit” A: Deklaratë “Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës”.
- Katalog me emërtimin “ Naugra_Katalog.pdf”.

III.1.4. Në nenin 77, pika 1 dhe 4 “Kërkesat për kualifikim” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

[...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”.

III.1.5. Në nenin 40 pika 6 germa b) “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:
b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose [...]

III.1.6. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” , i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë

e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

III.1.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente, duhet të refuzohen si të papranueshme. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për produktet që do të ofrojnë, e rrjedhimisht është e drejtë e këtij të fundit t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat e cilësisë. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/ kriterëve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.8. Referuar sa më sipër, Komisioni vëren se në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar dokumentet që duhet të paraqitin operatorët ekonomikë pjesëmarrës, dhe nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK, në përmbushje të kriterit të veçantë të kualifikimit, pika 4 e pikës 2.3. “kapaciteti teknik”, Komisioni konstaton, se ky i fundit, ka dorëzuar dokumentacionin Katalog me emërtimin “Naugra_Katalog.pdf.” Nga analizimi i ofertës teknike të dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (SPE), Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se operatori ekonomik si pjesë të ofertës së tij, ka dorëzuar dokumentacione të kërkuar në dokumentet standarde të tenderit, Naugra_Katalog.pdf për artikujt që ka ofruar dhe që janë kërkuar të prokurohen nga ana e autoritetit kontraktor për artikujt listuar. Komisioni konstatoi se dokumentacioni i dorëzuar nga operatori ekonomik në përmbushje të parametrave për artikujt objekt ankimi, përmban të dhëna të qarta, sipas parametrave në tërësi dhe në veçanti parametrat objekt ankimimi, si vijon:

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin nr.1 Aparat Disgregimi (Për djegien e mostrave) se:** Nuk përmbush specifikimet teknike respektivisht:

“....-Pajisja duhet të ketë panel kontrolli me ekran digjital për programim të parametrave të procesit (kohë disgregimi, intesiteti)

-Të ketë system mbrojtës për ndalimin e menjëhershëm në rast emergjence ose bllokimi.

-Kapak mbrojtës transparent që lejon mbi këqyrjen e procesit dhe parandalon aksesin gjatë funksionimit.

-Mbrojtje kundër mbinxehjes dhe mbingarkesës.

-Pjesët e kontaktit me mostrat duhet të jenë prej çeliku inox ose material rezistente ndaj korrozionit dhe kontaminimit....”, Komisioni, konstaton se për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentacionin Katalog me emërtimin “Naugra_Katalog.pdf në të cilin janë përcaktuar specifikimet si më poshtë;

- ☐ Proces plotësisht automatik i zbërthimit
- ☐ Kapaciteti minimal i serisë: të paktën 8 mostra për cikël
- ☐ Mundëson tretjen e plotë të mostrës për analiza të mëtejshme
- ☐ I përshtatshëm për mostra toke, ushqimi dhe materialesh organike
- ☐ Panel kontrolli dixhital me kohë dhe temperaturë të programueshme të zbërthimit
- ☐ Memorie programi për metodat e përdorura shpesh
- ☐ Fillimi dhe mbarimi automatik i ciklit të programuar
- ☐ Funksion ndalimi emergjent dhe mbrojtje nga bllokimi
- ☐ Motor me fuqi të lartë për zbërthim efikas
- ☐ Ndërtim mekanik i qëndrueshëm i gradës laboratorike
- ☐ Kapak mbrojtës transparent për monitorimin e procesit dhe sigurinë e operatorit
- ☐ Mbrojtje nga mbinxehja dhe mbingarkesa
- ☐ Pjesë kontakti me mostrën të bëra prej çeliku inox ose materiali rezistent ndaj korrozionit
- ☐ Furnizim me energji: 230 V, 50/60 Hz
- ☐ Konsumi maksimal i energjisë: ≤ 2000 W
- ☐ Furnizohet me gota shpërbërjeje, kapakë mbrojtës dhe manual përdorimi (anglisht)

Përsa i përket specifikimit *Pajisja duhet të ketë panel kontrolli me ekran digjital për programim të parametrave të procesit (kohë disgregimi, intensiteti) konkretisht intensiteti dhe specifikimi Pjesët e kontaktit me mostrat duhet të jenë prej çeliku inox ose material rezistente ndaj korrozionit dhe kontaminimit për të cilët operatori ekonomik ankimues pretendon se nuk plotësohet nga operatori ekonomik CARPATHIA ALBANIA” SHPK , komisioni konstaton se këto specifikime jantë ndryshuar me shtojcën nr., datë 19.12.2025 në Pajisja duhet të ketë panel kontrolli me ekran digjital për programim të parametrave të procesit (kohë disgregimi, temperaturë e programueshme) dhe Pjesët e kontaktit me mostrat duhet të jenë prej çeliku inox ose material rezistente ndaj korrozionit.*

Komision nga analizimi i parametrave të katalogut për Art nr. 1 Aparat Disgregimi (Për djegien e mostrave)., gjykon se operatori ekonomik, ka arritur të përmbushë specifikimet teknike me ofertën e tij në lidhje me *Pajisja duhet të ketë panel kontrolli me ekran digjital për programim të parametrave të procesit (kohë disgregimi, temperaturë e programueshme); Të ketë system mbrojtës për ndalimin e menjëhershëm në rast emergjence ose bllokimi. -Kapak mbrojtës transparent që lejon mbi këqyrjen e procesit dhe parandalon aksesin gjatë funksionimit. - Mbrojtje kundër mbinxehjes dhe mbingarkesës. Pjesët e kontaktit me mostrat duhet të jenë prej çeliku inox ose material rezistente ndaj korrozionit.* Sqarojmë se autoriteti kontraktor vlerëson vlefshmërinë e ofertës bazuar në të dhënat e katalogëve përkatës të pajisjeve të kërkuara në procedurë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e dokumentacionit të ofertuesit e ka krye në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit. Për sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK përmbush specifikimet teknike në lidhje me parametrat e artikullit nr.1 Aparat Disgregimi (Për djegien e mostrave).

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin nr.3 Peshore teknike se:** Nuk përmbush specifikimet teknike respektivisht:

“....-- *Densitet; përputhje me printer/PC.*

- *Të ketë të deklaruar shmangien termike; sigurim standard stabiliteti laboratorik.*

- *Printer, tabletë, density kit, tastier alfa numerike, gurë kalibrimi 200 g,.....”, Komisioni, konstaton se për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentacionin Katalog me emërtimin “Nagra_Katalog.pdf në të cilin janë përcaktuar specifikimet si më poshtë;*

- ☐ Kapaciteti maksimal: 2000 g
- ☐ Rezolucioni: 0.01 g
- ☐ Riprodhueshmëria: ± 0.01 g
- ☐ Lineariteti: $\pm 0.02-0.03$ g
- ☐ Diametri i tepsisë së peshimit: 80–130 mm
- ☐ Sistem i brendshëm vetë-kalibrimi
- ☐ Funksioni i përcaktimit të dendësisë
- ☐ Pajtueshmëria me PC dhe printer
- ☐ Kontroll i deklaruar i devijimit termik

☐ I projektuar për stabilitet laboratorik

Aksesorë:

☐ Printer

☐ Ndërfaqja e tabletit

☐ Kit dendësie

☐ Tastierë alfanumerike

☐ Pesha e kalibrimit (200 g).

Komision nga analizimi i parametrave të katalogut për Art nr.3 Peshore teknike., gjykon se operatori ekonomik, ka arritur të përmbushë specifikimet teknike me ofertën e tij në lidhje me *Densitet; përputhje me printer/PC; Të ketë të deklaruar shmangien termike; sigurim standard stabiliteti laboratorik; Printer, tabletë, density kit, tastier alfa numerike, gurë kalibrimi 200 g.* Sqarojmë se autoriteti kontraktor vlerëson vlefshmërinë e ofertës bazuar në të dhënat e katalogëve përkatës të pajisjeve të kërkuara në procedurë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e dokumentacionit të ofertuesit e ka krye në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit. Për sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK përmbush specifikimet teknike në lidhje me parametrat e artikullit nr.3 Peshore teknike.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin nr.4 Peshore analitike se:** Nuk përmbush specifikimet teknike respektivisht:

“....--*Densitet; përputhje me printer/PC.*

- *Të ketë të deklaruar shmangien termike; sigurim standard stabiliteti laboratorik.*

- *Printer, tabletë, tastier alfa numerike.....*”, Komisioni, konstaton se për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentacionin Katalog me emërtimin “Naugra_Katalog.pdf në të cilin janë përcaktuar specifikimet si më poshtë;

☐ Kapaciteti maksimal: 220 g

☐ Rezolucioni: 0.1 mg

☐ Riprodhueshmëria: ± 0.1 mg

☐ Lineariteti: ± 0.2 mg

☐ Diametri i enës së peshimit: ≤ 90 mm

☐ Mbulesë xhami kundër rrymës

☐ Sistem i brendshëm vetëkalibrimi

☐ Funksioni i përcaktimit të dendësisë

☐ Pajtueshmëria me PC dhe printer

☐ Kontroll i deklaruar i devijimit termik

☐ Sigurimi i stabilitetit laboratorik

☐ Printer

☐ Ndërfaqja e tabletit

☐ Tastierë alfanumerike

Komision nga analizimi i parametrave të katalogut për Art nr.4 Peshore analitike., gjykon se operatori ekonomik, ka arritur të përmbushë specifikimet teknike me ofertën e tij në lidhje me *Densitet; përputhje me printer/PC; Të ketë të deklaruar shmangien termike; siguri standard stabiliteti laboratorik;Printer, tabletë, tastier alfa numerike*. Sqarojmë se autoriteti kontraktor vlerëson vlefshmërinë e ofertës bazuar në të dhënat e katalogëve përkatës të pajisjeve të kërkuara në procedurë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e dokumentacionit të ofertuesit e ka krye në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit. Për sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK përmbush specifikimet teknike në lidhje me parametrat e artikullit nr.4 Peshore analitike.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin nr.6 Mulli për bluarjen e mostrave se:** Nuk përmbush specifikimet teknike respektivisht:

“.....-Teknologjia e triturimit

- *Distanca midis disqeve të jetë e komandushme*

- *Sistemi i mbylljes hermetike*

- *Sistem për nxjerrje pluhuri,.....*”, Komisioni, konstaton se për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentacionin Katalog me emërtimin “Naugra_Katalog.pdf në të cilin janë përcaktuar specifikimet si më poshtë;

☐ Metoda e bluarjes: teknologjia e thërmimit

☐ Kapaciteti: 2–2.5 kg

☐ Komponentët e bluarjes janë bërë prej çeliku inox ose çeliku të veshur

☐ Distanca e rregullueshme midis disqeve të bluarjes

☐ I përshtatshëm për përdorim në laborator të brendshëm

☐ Funksionim me zhurmë të ulët

☐ Sistemi i mbyllur me avull

☐ Çelës sigurie i integruar

☐ Sistemi i nxjerrjes së pluhurit i përfshirë

Komision nga analizimi i parametrave të katalogut për Art nr.6 Mulli për bluarjen e mostrave, gjykon se operatori ekonomik, ka arritur të përmbushë specifikimet teknike me ofertën e tij në lidhje me *Teknologjia e triturimit; Distanca midis disqeve të jetë e komandushme; Sistemi i mbylljes hermetike ;Sistem për nxjerrje pluhuri*. Sqarojmë se autoriteti kontraktor vlerëson vlefshmërinë e ofertës bazuar në të dhënat e katalogëve përkatës të pajisjeve të kërkuara në procedurë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e dokumentacionit të ofertuesit e ka krye në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit. Për sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK përmbush specifikimet teknike në lidhje me parametrat e artikullit nr. 6 Mulli për bluarjen e mostrave.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin nr.9 Distilator uji se:**
Nuk përmbush specifikimet teknike respektivisht:

“.....-Konduktivitet $\leq 2.3 \mu\text{S/cm}$ në 25°C

- Mbushje automatike, sistem monitorimi kontaminimi me ndalje automatik dhe sinjal vizual; vetstakim kur ndërpritet furnizimi me ujë

- Çelik inox për evaporator, kondensator, rezervuar dhe komponentë të distilimit

- Pajisja me rezervuar të integruar, kran dalëse, manual përdorimi, sistem matjeje elektronik për nivel uji, sistem mbrojtjeje dhe testimi automatik,.....”, Komisioni, konstaton se për përmbushjen e këtij kriteri operatorit ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentacionin Katalog me emërtimin “Naugra_Katalog.pdf në të cilin janë përcaktuar specifikimet si më poshtë;

☐ Kapaciteti i prodhimit të ujit të distiluar: 8–12 L/orë

☐ Rezervuari i integruar i ruajtjes së distilatit: 20 L

☐ Përçueshmëria e distilimit: $\leq 2.3 \mu\text{S/cm}$ në 25°C

☐ Funksionim plotësisht automatik me:

☐ Mbushje automatike

☐ Monitorim i ndotjes

☐ Ndalesë automatike me alarm vizual

☐ Funksion vetë-kullimi gjatë ndërprerjes së furnizimit me ujë

☐ Komponentët e avulluesit, kondensatorit, rezervuarit dhe distilimit të bërë nga çelik inox

☐ Ndërtim i sigurt laboratorik me komponentë të standardizuar

Furnizuar me:

☐ Rezervuar i integruar

☐ Rubinet daljeje

☐ Sistem elektronik i matjes së nivelit të ujit

☐ Sistem automatik mbrojtjeje dhe testimi

☐ Parafiltra uji në rrjet

☐ Manual përdorimi

☐ Furnizim me energji: 220 V, 50–60 Hz

Komision nga analizimi i parametrave të katalogut për Art nr.9 Distilator uji, gjykon se operatorit ekonomik, ka arritur të përmbushë specifikimet teknike me ofertën e tij në lidhje me *Konduktivitet $\leq 2.3 \mu\text{S/cm}$ në 25°C ; Mbushje automatike, sistem monitorimi kontaminimi me ndalje automatik dhe sinjal vizual; vetstakim kur ndërpritet furnizimi me ujë; Çelik inox për evaporator, kondensator, rezervuar dhe komponentë të distilimit; Pajisja me rezervuar të integruar, kran dalëse, manual përdorimi, sistem matjeje elektronik për nivel uji, sistem mbrojtjeje dhe testimi automatik.* Sqarojmë se autoriteti kontraktor vlerëson vlefshmërinë e ofertës bazuar në të dhënat e katalogëve përkatës të pajisjeve të kërkuara në procedurë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e dokumentacionit të ofertuesit e ka krye në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit. Për sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatorit ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK përmbush specifikimet teknike në lidhje me parametrat e artikullit nr. 9 Distilator uji.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin nr.12 Tundese linearese**: Nuk përmbush specifikimet teknike respektivisht:

“.....-Diapazon operimi: +10 °C deri +35 °C.

- Dridhje horizontale me amplitudë të rregullueshme, te pakten tre opsione

- Interval shpejtësie, i ngadaltë mesatare dhe i shpejtë

- Panel për kontrollin e amplitudës dhe monitorimin e shpejtësisë së tundjes; funksione alarmi dhe mbrojtjeje,.....”, Komisioni, konstaton se për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentacionin Katalog me emërtimin “Naugra_Katalog.pdf në të cilin janë përcaktuar specifikimet si më poshtë;

☐ Kapaciteti i prodhimit të ujit të distiluar: 8–12 L/orë

☐ Diapazoni i temperaturës së funksionimit: +10 °C deri në +35 °C

☐ Dridhje horizontale me minimum 3 nivele amplitude të rregullueshme

☐ Modalitetet e shpejtësisë: të ngadalta, të mesme, të shpejta

☐ Ngarkesa maksimale e platformës: 5–6 kg

☐ Paneli i kontrollit për shpejtësinë dhe amplitudën e dridhjeve

☐ Funksione alarmi dhe mbrojtjeje

☐ Strukturë e fortë me materiale rezistente ndaj korrozionit

☐ Pjesë kontakti me mostrën të bëra nga material jo reaktiv

☐ Furnizim me energji: 220 V, 50/60 Hz

☐ I certifikuar CE me mbrojtje nga mbingarkesa

Furnizohet me:

☐ Platformë vibruese

☐ Kabllot e nevojshme

☐ Manual përdorimi

Komision nga analizimi i parametrave të katalogut për Art nr. 12 Tundese linearese, gjykon se operatori ekonomik, ka arritur të përmbushë specifikimet teknike me ofertën e tij në lidhje me Diapazon operimi: +10 °C deri +35 °C; Dridhje horizontale me amplitudë të rregullueshme, te pakten tre opsione; Interval shpejtësie, i ngadaltë mesatare dhe i shpejtë; Panel për kontrollin e amplitudës dhe monitorimin e shpejtësisë së tundjes; funksione alarmi dhe mbrojtjeje. Sqarojmë se autoriteti kontraktor vlerëson vlefshmërinë e ofertës bazuar në të dhënat e katalogëve përkatës të pajisjeve të kërkuara në procedurë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e dokumentacionit të ofertuesit e ka krye në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit. Për sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK përmbush specifikimet teknike në lidhje me parametrat e artikullit nr. 12 Tundese linearese.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin nr.13 Pajisje distilimi (Model automatik ose gjysem automatik)**: Nuk përmbush specifikimet teknike respektivisht:

“....-Sasia e mostrës Solide <6 g; Lëngje <16 ml

- *Koha e matjes 4–6 minuta (me ujëftohës 18°C)*
- *Kërkesa për ujë ftohës <20°C*
- *Koncentrimi i solucionit. titrimi 0.01 – 5 mol/L*
- *Koeficienti i rikuperimit $\geq 99.5\%$*

- *Afishon kurbën e titrimit në kohë reale*
- *Të ketë opsion vetpastrimi*
- *Ekran i madh LCD me prekje*
- *Burim drite me trengjyra (R, G, B) dhe sensor trefish për përshtatshmëri të gjerë ndaj ngjyrave dhe saktësi të lartë*
- *Funksione të shumta mbrojtjeje: derë sigurie, mbrojtje ndaj mbingarkesës me presion, mungesë uji etj.....*”, Komisioni, konstaton se për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentacionin Katalog me emërtimin “Naugra_Katalog.pdf në të cilin janë përcaktuar specifikimet si më poshtë;

☐ Diapazoni i matjes: 0.1–240 mg N

Sasia e mostrës:

☐ Lëndë të ngurta: < 6 g

☐ Lëngje: < 16 mL

☐ Koha e matjes: 4–6 minuta (me ujë ftohës 18 °C)

☐ Kërkesa për ujë ftohës: < 20 °C

☐ Diapazoni i përqendrimit të titrimit: 0.01–5 mol/L

☐ Sistem titrimi me piston me precizion të lartë

☐ Përsëritshmëria: $\pm 0.5\%$

☐ Koeficienti i rikuperimit: $\geq 99.5\%$

☐ Memoria e të dhënave: $\geq 100,000$ rezultate

☐ Shfaqja e kurbës së titrimit në kohë reale

☐ Funksion opsional i vetëpastrimit

☐ Shkarkimi automatik i mbeturinave në tubin e tretësit

☐ Ekran i madh me prekje LCD

☐ Sistem kontrolli me precizion të lartë me performancë të qëndrueshme

☐ Burim drite trengjyrësh (RGB) me sensor të trefishtë

☐ Materiali i ndërtimit: Çelik inox 304

Siguri e shumëfishtë mbrojtje:

☐ Siguria e derës

☐ Mbingarkesa me presion

☐ Mbrojtja nga mungesa e ujit

☐ Furnizimi me energji: AC 220 V, 50/60 Hz

Komision nga analizimi i parametrave të katalogut për Art nr.13 Pajisje distilimi (Model automatik ose gjysem automatik), gjykon se operatori ekonomik, ka arritur të përmbushë specifikimet teknike me ofertën e tij në lidhje me *Sasia e mostrës Solide <6 g; Lëngje <16 ml; Koha e matjes 4–6 minuta (me ujëftohës 18°C); Kërkesa për ujë ftohës <20°C; Koncentrimi i solucionit. titrimi 0.01 – 5 mol/L; Koeficienti i rikuperimit $\geq 99.5\%$; Afishon kurbën e titrimit në kohë reale; Të ketë opsion vetpastrimi; Ekran i madh LCD me prekje; Burim drite me trengjyra (R, G, B) dhe sensor trefish për përshtatshmëri të gjerë ndaj ngjyrave dhe saktësi të lartë; Funksione të shumta mbrojtjeje: derë sigurie, mbrojtje ndaj mbingarkesës me presion, mungesë*

uji etj... Sqarojmë se autoriteti kontraktor vlerëson vlefshmërinë e ofertës bazuar në të dhënat e katalogëve përkatës të pajisjeve të kërkuara në procedurë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e dokumentacionit të ofertuesit e ka krye në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit. Për sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK përmbush specifikimet teknike në lidhje me parametrat e artikullit nr.13 Pajisje distilimi (Model automatik ose gjysem automatik).

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin nr.15 Analizator azoti protein dhe C-organik:** Nuk përmbush specifikimet teknike respektivisht:

- “....-Dhoma e djegies jo më pak se 9000C
- TCD pa gaz reference; kufiri detektimit 0.003 mg N;
 - Rikuperim > 99.5%, C-organik 0.003mg
 - Pesha mostra ≤ 1 g;
 - He (99.999 %, 2 bar), O (99.999 %, 2 bar); ajër/azot ≥ 99.6 %.
 - Platforma me monitorim në kohë reale

. Përputhshmëria dhe standardet:

- EN ISO 16634-1:2008, SSH ISO 10694:2001, SSH ISO13878:2001..”, Komisioni, konstaton se për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentacionin Katalog me emërtimin “Naugra_Katalog.pdf në të cilin janë përcaktuar specifikimet si më poshtë;
Përshkrimi:

☐ Analizues elementar i bazuar në djegie për përcaktimin e azotit, proteinave dhe karbonit organik.

Specifikimet:

- ☐ Metoda e analizës: Djegie Dumas
- ☐ Temperatura e dhomës së djegies: ≥ 900 °C
- ☐ Detektor: TCD pa gaz referues

Limiti i zbulimit:

- ☐ Azot: 0.003 mg
- ☐ Karbon organik: 0.003 mg
- ☐ Rikuperimi: > 99.5%
- ☐ Pesha maksimale e mostrës: ≤ 1 g

Kërkesat për gaz:

- ☐ Helium: 99.999%, 2 bar
- ☐ Oksigjen: 99.999%, 2 bar
- ☐ Ajër / azot: ≥ 99.6 %
- ☐ Proces i kontrolluar nga kompjuteri me monitorim në kohë reale

Komision nga analizimi i parametrave të katalogut për Art nr.15 Analizator azoti protein dhe C-organik, gjykon se operatori ekonomik, ka arritur të përmbushë specifikimet teknike me ofertën e tij në lidhje me *Dhoma e djegies jo më pak se 9000C; TCD pa gaz reference; kufiri detektimit 0.003 mg N; Rikuperim > 99.5%, C-organik 0.003mg; Pesha mostra ≤ 1 g; He (99.999 %, 2 bar), O (99.999 %, 2 bar); ajër/azot ≥ 99.6 %.* Platforma me monitorim në kohë

reale;. Përputhshmëria dhe standardet: EN ISO 16634-1:2008, SSH ISO 10694:2001, SSH ISO13878:2001... Sqarojmë se autoriteti kontraktor vlerëson vlefshmërinë e ofertës bazuar në të dhënat e katalogëve përkatës të pajisjeve të kërkuara në procedurë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e dokumentacionit të ofertuesit e ka krye në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit. Për sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK përmbush specifikimet teknike në lidhje me parametrat e artikullit nr.15 Analizator azoti protein dhe C-organik.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin nr.18 Pajisje distilimi (Kjeldahl manual)**: Nuk përmbush specifikimet teknike respektivisht:

“....-Kapaciteti deri në 6 mostra simultane (6-element seriali KI) për balona Kjeldahl nga 250 ml, 500–750 ml për çdo vend

- Ngrohje individuale: çdo element ngrohës ka komandim të veçantë dhe kontroll të temperaturës, për mostra me pika vlimi të ndryshme, me ngrohës performues të shpejtë

- Ngrohës: element tubular inox me reflektor çelik për efikasitet termik maksimal;

- Aparat komplet distilimi me Reitmaier top(e), kondensatorë, dalje dhe gomë lidhëse

- Sisteme thithjeje tymi: mundësia për integrim me pompë uji ose sistem për heqje tymrash korrozivë gjatë procesit Kjeldahl;

- Materiale rezistente ndaj temperaturave të larta dhe kimikateve.....”, Komisioni, konstaton se për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentacionin Katalog me emërtimin “Nagra_Katalog.pdf në të cilin janë përcaktuar specifikimet si më poshtë;

Përshkrim:

☐ Sistem distilimi manual për analizën e azotit Kjeldahl.

Specifikimet:

☐ Kapaciteti: 6 mostra të njëkohshme

☐ I pajtueshëm me balona Kjeldahl 500 mL

☐ Kontroll i pavarur i ngrohjes për secilën pozicion

☐ Ngrohës tubularë çeliku inox me veprim të shpejtë

☐ Reflektorë çeliku për efikasitet të lartë termik

Furnizohet me:

☐ Njësi ngrohjeje (6 pozicione)

☐ Kit distilimi me kondensatorë dhe lidhje

☐ Balona Kjeldahl (250 mL, 500 mL, 750 mL)

☐ Pranues i balonave Erlenmeyer

☐ Manual instalimi dhe operimi

☐ Shitësi duhet të sigurojë instalimin dhe përshtatjen

☐ Pajisje për nxjerrjen e tymit ose integrimin e pompës së ujit

☐ Strukturë e qëndrueshme me materiale rezistente ndaj nxehtësisë dhe kimikateve

Përsa i përket specifikimit Kapaciteti deri në 6 mostra simultane (6-element seriali KI) për balona Kjeldahl nga 250 ml, 500–750 ml për çdo vend për të cilët operatori ekonomik ankimues pretendon se nuk plotësohet nga operatori ekonomik CARPATHIA ALBANIA” SHPK, komisioni konstaton se këto specifikime janë ndryshuar me shtojcën nr., datë 19.12.2025 në

Kapacitet dhe dizajn fizik Kapaciteti deri në 6 mostra simultane (6-element seriali KI) për balona Kjeldahl 500 ml për çdo vend.

Komision nga analizimi i parametrave të katalogut për Art nr. 18 Pajisje distilimi (Kjeldahl manual), gjykon se operatori ekonomik, ka arritur të përmbushë specifikimet teknike me ofertën e tij në lidhje me “....-Kapaciteti deri në 6 mostra simultane (6-element seriali KI) për balona Kjeldahl nga 250 ml, 500–750 ml për çdo vend; Ngrohje individuale: çdo element ngrohës ka komandim të veçantë dhe kontroll të temperaturës, për mostra me pika vlimi të ndryshme, me ngrohës përformues të shpejtë; Ngrohës: element tubular inox me reflektor çelik për efikasitet termik maksimal; Aparat komplet distilimi me Reitmaier top(e), kondensatorë, dalje dhe gomë lidhëse; Sisteme thithjeje tymi: mundësia për integrim me pompë uji ose sistem për heqje tymrash korrozivë gjatë procesit Kjeldahl; Materiale rezistente ndaj temperaturave të larta dhe kimikateve... Sqarojmë se autoriteti kontraktor vlerëson vlefshmërinë e ofertës bazuar në të dhënat e katalogëve përkatës të pajisjeve të kërkuara në procedurë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e dokumentacionit të ofertuesit e ka krye në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit. Për sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK përmbush specifikimet teknike në lidhje me parametrat e artikullit nr. 18 Pajisje distilimi (Kjeldahl manual).

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues **për artikullin nr.19 Kontenjer 400-500 lit për mbajtjen e materialit biologjik me azot të lëngshëm**: Nuk përmbush specifikimet teknike respektivisht:

“....-Kapaciteti: 6000 vials 1.2-2 ml, të sistemuara me kuti Cryogenic Box;
- Temperatura operative: nën -180°C (temperatura e azotit të lëngët $\sim -196^{\circ}\text{C}$), ruajtje e vazhdueshme edhe kur niveli i lëngut është nën 5 cm;
-Norma e avullimit statik: 0.99 L/ditë
-Kapacitet ruajtës statik: 185 ditë;
Monitorimi dhe siguri i nivelit: Opsional: Monitor ultrasonik i nivelit të azotit me alarm vizual dhe audio kur niveli bie nën ~ 2.5 cm;
-Raka standarde: përkutia 2 inç (5 cm) Cryogenic, duke ruajtur kutitë me 1.0-2.0 ml vials; mundësi për aksesore për ampula 5 ml;
-Pajisje të disponueshme: aksesore transporti, kapakë sigurie, CryoClac, logbook etj.....”, Komisioni, konstaton se për përmbushjen e këtij kriteri operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK ka paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike dokumentacionin Katalog me emërtimin “Nagra_Katalog.pdf në të cilin janë përcaktuar specifikimet si më poshtë;

Përshkrim:

☐ Enë kriogjenike për ruajtjen afatgjatë të mostrave biologjike në azot të lëngshëm. Specifikimet:

☐ Vëllimi i brendshëm: 180–200 L

☐ Kapaciteti i ruajtjes: ~ 6000 shishe (1.2–2 mL) me kuti kriogjenike

- ☐ Temperatura e funksionimit: $< -180\text{ }^{\circ}\text{C}$
- ☐ Ruajtje e vazhdueshme edhe me nivelin e lëngut nën 5 cm
- ☐ Shkalla e avullimit statik: $\sim 0.99\text{ L/ditë}$
- ☐ Kohëzgjatja e ruajtjes statike: $\sim 185\text{ ditë}$
- ☐ Diametri i jashtëm: $\sim 66\text{ cm}$
- ☐ Diametri i qafës: $\geq 50\text{ cm}$
- ☐ Mbushje manuale e dewarit me azot të lëngshëm
- ☐ Izolim vakumi me efikasitet të lartë
- ☐ Materialet e ndërtimit: çelik inox dhe alumin
- ☐ Monitor opsional tejzanor i nivelit të azotit me alarm audio-vizual

I pajtueshëm me:

- ☐ Kuti kriogjenike 2 inç
- ☐ Shishe 1–2 mL
- ☐ Ampula opsionale 5 mL
- ☐ Aksesorë të disponueshëm: ndihma transporti, kapak i sigurt, kapëse kriogjenike, ditar regjistrimi

Komision nga analizimi i parametrave të katalogut për Art nr. 19 Kontenjier 400-500 lit per mbajtjen e materialit biologjik me azot te lengshem, gjykon se operatori ekonomik, ka arritur të përmbushë specifikimet teknike me ofertën e tij në lidhje me *Kapaciteti: 6000 vials 1.2-2 ml, të sistemuara me kuti Cryogenic Box; Temperatura operative: nën $-180\text{ }^{\circ}\text{C}$ (temperatura e azotit të lëngët $\sim -196\text{ }^{\circ}\text{C}$), ruajtje e vazhdueshme edhe kur niveli i lëngut është nën 5 cm; Norma e avullimit statik: 0.99 L/ditë ; Kapacitet ruajtës statik: 185 ditë; Monitorimi dhe sigurimi i nivelit: Opsional: Monitor ultrasonik i nivelit të azotit me alarm vizual dhe audio kur niveli bie nën $\sim 2.5\text{ cm}$; Raka standarde: për kutia 2 inç (5 cm) Cryogenic, duke ruajtur kutitë me 1.0-2.0 ml vials; mundësi për aksesore për ampula 5 ml; Pajisje të disponueshme: aksesorë transporti, kapakë sigurie, CryoClaë, logbook etj...* Sqarojmë se autoriteti kontraktor vlerëson vlefshmërinë e ofertës bazuar në të dhënat e katalogëve përkatës të pajisjeve të kërkuara në procedurë. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se autoriteti kontraktor në rastin konkret, vlerësimin e dokumentacionit të ofertuesit e ka krye në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet standarde të tenderit. Për sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “CARPATHIA ALBANIA” SHPK përmbush specifikimet teknike në lidhje me parametrat e artikullit nr. 19 Kontenjier 400-500 lit per mbajtjen e materialit biologjik me azot te lengshem.

Për sa më lart, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr.

500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “ISOMETRIC” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, mbi kufirin e lartë monetar”, me nr. REF-64236-10-09-2025, me objekt “Blerje pajisje laboratorike për QTTB Fushë-Krujë”, me fond limit 17,488,500 (shtatëmbëdhjetë milion e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e pesëqind) lekë pa TVSH ose 180,778.37 (njëqind e tetëdhjetë mijë e shtatëqind e shtatëdhjetë e tetë pikë tridhjetë e shtatë) euro pa TVSH, zhvilluar më datë 16.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqendruara sh.a.
 2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ISOMETRIC” SHPK.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

